

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Ishte kënaqësi të mirëpres sot në takime të ndara përfaqësues të bizneseve, bankave komerciale dhe Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive, të cilët së bashku me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës kanë krijuar një partneritet mjaft efektiv në mbështetje të ekonomisë së vendit gjatë kësaj periudhe jo të lehtë.

BQK-ja së bashku me përfaqësuesit e bizneseve dhe bankat komerciale që operojnë në vend, identifikuan me kohë nevojat që kishte biznesi dhe qytetarët për të përballuar më lehtë vështirësitë që rrodhën nga kriza pandemike dhe bazuar në këto nevoja, reaguam me kohë në lehtësimin e barrës së pagesës së kësteve kreditore për huamarrësit, duke bërë kështu që të zvogëlohen pasojat ekonomike të kësaj krize në vendin tonë.

Sidoqoftë, vështirësitë që ka shkaktuar kjo krizë ende po vazhdojnë të jenë të pranishme në ekonominë tonë dhe varësisht nga zhvillimet e lidhura me masat e mundshme kufizuese, bizneset mund të vazhdojnë të ballafaqohen me vështirësi të ngjashme edhe gjatë periudhës në vijim.

Për këtë arsye, ne jemi mbledhur sot për të diskutuar lidhur me sfidat me të cilat po ballafaqohen bizneset dhe për mundësitë e fuqizimit të mëtejshëm të rolit të sektorit bankar në mbështetje të rimëkëmbjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të bizneseve.

Siç e dini, njëra ndër shtyllat kryesore të planit të rimëkëmbjes ekonomike mbështetet pikërisht në lehtësimin e qasjes në financa përmes shfrytëzimit të skemës për garantimin e kredive që ofrohet nga Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive. Prandaj, ne e shfrytëzuam këtë takim për të diskutuar rreth efektivitetit të këtij programi të garantimit të kredive për të mbështetur ata që kanë nevojë që të përfitojnë nga ky program.

Me këtë rast, potencuam rëndësinë që FKGK-ja ta zbatojë në shkallë sa më të lartë misionin e saj në lehtësimin e qasjes në financa të shtresave apo sektorëve me qasje të vështirësuar në financa, duke u lehtësuar qasjen në financim bankar posaçërisht atyre që kanë vështirësi ta sigurojnë atë në mënyrë të pavarur.

Ne konsiderojmë që masat rregullore të BQK-së për trajtimin e kredive të garantuara nga FKGK si asete pa rrezik për bankat, të cilat paraqesin një lehtësim shumë të rëndësishëm për sa i përket kërkesave rregullore për kapital ndaj bankave, si dhe mbulesa e tarifës garantuese nga Qeveria e Kosovës, paraqesin lehtësime shumë të rëndësishme, të cilat konsiderojmë se do të reflektojnë në kushte më të favorshme nga ana e institucioneve kredidhënëse për kreditë e garantuara.

Ne mbetemi të përkushtuar që këtë partneritet ta fuqizojmë edhe më tutje përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe harmonizimit të politikave në mënyrë, që ato të jenë sa më efektive në mbështetje të rimëkëmbjes dhe zhvillimit të ekonomisë së vendit.